



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)

Data: 06 Shkurt 2019

## **Njoftim**

### **Refundimi i mjeteve për miellin pa-gluten për fëmijët e prekur me sëmundjen e Celiakisë**

Për shak të mungesës së miellit pa-gluten nëpër barnatore si dhe nga reagimi i personave të siguruar që nuk mund t'a realizojnë të drejtën e miellit pa-gluten me anë të recetave që i mbulon Fondi, Ju informojmë:

Pacientët që janë furnizuar privatisht me mielli pa-gluten gjatë muajit Janar dhe Shkurt 2019 nga cilido qoftë vend shitës, do mund t'i refundojnë mjetet nga Fondi në vlerë të çmimit referent.

Për t'a realizuar të drejtën e refundimit të mjeteve për miellin pa-gluten, të siguruarit do të duket të parashtrajnë Kërkesë tek njësitë rajonale e Fondit së bashku me këto dokumente: Recetën, Raport nga mjeku specialist ose mendimin konziliar që është në pajtueshmëri me diagnozën ku përcaktohet nevoja e shfrytëzimit të miellit pa-gluten dhe llogarinë fiskale.

Dari sa të arrihet një zgjedhje e përhershme, Fondi me anë të refundimit të mjeteve do t'a tejkalojë problemin e përkohshëm me të cilin ballafaqohen të siguruarit.